



FTESË E PËRGJITHSHME PËR SHPREHJE INTERESI PËR ANGAZHIMIN E EKSPERTËVE/KONSULENTEVE INDIVIDUAL

Data: 23.11.2021

Fondi për Zhvillimin e Komunitar është organizatë joqeveritare e cila synon të përmirësojë shërbimet e saj për komunitetet duke angazhuar konsulentë individual për periudha të caktuara kohore për zbatimin e projekteve të financuara nga donatorë të ndryshëm.

Në përputhje me Manualin e Veprimit dhe rregullat e CDF, dhe me qëllim të zbatimit të projekteve CDF fton të gjithë profesionistët e kualifikuar që të shprehin interesimin e tyre për t'u përfshirë në listën e bashkëpunëtorëve/eve të jashtëm/me të CDF-së, për fushat në vijim:

- Promovimi i Punës së Organizatës dhe Komunikimi përmes Mediave dhe Rrjeteve Sociale,
- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit,
- Çështje Ligjore,
- Qeverisja e Brendshme e OShC-ve,
- Media Sociale,
- Menaxhimi Publik,
- Reforma e Administratës Publike,
- Marrëdhëniet me Publikun,
- Sigurimi i Cilësisë,
- Sistemet dhe Proceset për Monitorim dhe Vlerësim(M&E) të Punës së Organizatës,
- Avokimi pjesëmarres,
- Integrimi gjinor,
- Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave,
- Menaxhimi i rrezikut,
- Trajnimi i stafit,
- Analiza e të dhënave,
- Menaxhimi i Projekteve,
- Menaxhimi i Eventeve,
- Të tjera (ju lutem specifikoni).

Të gjithë kandidatët e interesuar që dëshirojnë të aplikojnë duhet të dorëzojnë CV-të dhe rekomandimet për përvojën e mëparshme. Konsulentët duhet të kenë së paku pesë (5) vjet përvojë për secilën fushë përkatëse të përmendur më sipër. Kërkohet njohja e shkëlqyer e gjuhës shqipe, serbe dhe angleze.

Një listë e gjatë e profesionistëve të parakualifikuar do të krijohet sipas llojeve të ekspertizës, dhe zgjedhja e konsulentëve për angazhim bëhet përmes një komisioni të CDF-së prej tre anëtarësh duke krahasuar së paku tre kandidatë të kualifikuar të cilët janë më të përshtatshmit dhe përmbushin kërkesat e CDF-së.

CDF do ti pranoj CV-të dhe rekomandimet tuaja gjatë gjithë vitit nga data e publikimit deri me datën 23.11.2022 në ora 16:00, në email adresen hr@kcdf.org.